REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM**

**VENDIM**

Nr.**35** datë **20/09/2023**

# PËR

# KORIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL NE VENDIMIN NR. 17 DATË 30.05.2023 "PËR MIRATIMIN E KËKESËS PËR LEJE PËRDORIMI BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSITRIALE TË SUBJKEKTIT TEGOLA EDIL CENTRO SHPK " DHE NË LEJEN E PËRDORIMKIT TË BURIMIT UJOR ME NR. 000054 SERIE DSHËNË NGA KBU ISHËM, SUBJEKTI "TEGOLA EDIL CENTRO"

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", si dhe referuar nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative **"Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ"** *1. Organi publik,në cdo kohë,kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit,gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme,në një akt administrativ.2.Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet,si dhe të cdo kopje të njëhsuar të tij.* Në këto kushte: me kërkesë të subjektit u konstatua gabimi dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm ,

**V E N D O S I:**

1. Korrigjimin e vendimit nr. 17 datë 30/05/2023 të KBU Ishëm si më poshtë:
   *Në pikën e parë të vendimit korrigjohet emërtimi i subjektit dhe vendodhja. Nga emërtimi "Aquila Liquori" e shkruajtur gabim zëvëndësohët me "Tegola Edil Centro" shpk si dhe nga vendodhja "autostrada Tiranë Durrës njësia Administrative Kashar" zëvëndësohet me "Njësia Administrative nr.11 Rr. "Iliria" Laprakë".*

2. Korrigjimin e lejes nr.000054 serie dhënë me vendimin 17 datë 30/05/2023 nga KBU Ishëm si më poshtë :
   *Në pjësën ku shënohet bashkia/njësia administrative, "Kashar" zëvëndësohet me "Laprakë/Tiranë"*

3. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përvec gabimit material.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin ekëtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I BASENIT UJOR - ISHËM